



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 35, datë 23.05.2016

Për

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.49, DATË 11.11.2015 PËR “MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS””

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 16 pika 3 shkronja “a”, nenit 23, pikat 4 dhe 6, nenit 35, pika 5, shkronja “b”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pika 8, shkronja “a”, pikat 10 e 11 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 35, pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të bashkisë tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës” si më poshtë vijon:
“Shtimin e zonave të administrimit të parkimit në qytetin e Tiranës, duke zgjeruar hartën e zonave të destinuara për zonim, Aneksi nr.2 dhe respektivisht nënzonat e destinuar për parkim sipas hartës bashkëlidhur:
 - Sheshi në anën juglindore të sheshit “Frederik Shopen”;
 - Sheshi në anën jugperëndimore të rrugës së “Kosovarëve”;
 - Sheshi pranë zonës së digës;
 - Sheshi në anën juglindore të “Juvenilja Castelo””.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë, Drejtoria e Aseteve dhe Tirana Parking.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI